



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
MINISTRI

Nr. 3957 Prot.

Tiranë, më 01.09.2015

URDHËR

Nr. 362 datë 01.09.2015

PËR

ZHVILLIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË PERSONELIT INFERMIEROR NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33 të Ligjit nr. 10 107, datë 30.08.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 5, pika 1, të "Rregullores për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të personelit infermieror në kujdesin shëndetësor",

URDHËROJ:

1. Procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive praktike të personelit infermieror në kujdesin shëndetësor parësor për vitin 2015 të kryhet në datën 27 shtator 2015.
2. Përfshihen nga procesi i vlerësimit për vitin 2015 kategoritë e mëposhtme:
  - a. infermieret (femra) lindur përpara datës 1 janar 1958;
  - b. infermierët (meshkuj) lindur përpara datës 1 janar 1953;
  - c. personeli infermieror, i licencuar nga Urdhëri i Infermierit pas datës 1 janar 2014.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe drejtoritë e institucioneve të kujdesit shëndetësor, punonjësit e të cilëve do të vlerësohen, për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

